VENDIM
Nr.1540, datë 19.11.2008

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË KRYERJES SË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR ZYRËN E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM, SI AUTORITET KONTRAKTOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm t'i përfundojë procedurat e prokurimit, për mallra dhe shërbime, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit të vitit 2008, brenda datës 31 dhjetor 2008.

Brenda këtij afati përfshihen edhe nënshkrimi dhe realizimi i kontratës.

2. Ngarkohen Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha